



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË C (1) – GREQISHT

Ngarkesa: 6 kredite; 60 seminare

Viti akademik: 2024– 2025 , Viti I , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: studentët do të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për t'iu përgjigjur situatave dhe strukturave gjuhësore të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (me gojë ose me shkrim); do të njihen me rregullat shoqërore gjuhësore dhe jo-gjuhësore; do të njihen me karakteristikat themelore të kulturës greke në nivel fillestar – A1.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Zhvillimi i aftësive gjuhësore bazë: Studentët do të përvetësojnë dhe zhvillojnë katër aftësitë kryesore gjuhësore – të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit – në gjuhën greke, duke u aftësuar për komunikim të përditshëm dhe ndërkulturor.
- 2.Aftësi komunikimi në situata të ndryshme: Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe të prodhojnë gjuhë të folur dhe të shkruar në situata praktike të jetës shoqërore, personale dhe profesionale, si edhe të interpretojnë e shkruajnë udhëzime të shkurtra.
- 3.Saktësi gjuhësore dhe përkthim: Kursi synon të pajisë studentët me saktësi gjuhësore në përdorimin e greqishtes dhe një nivel të kënaqshëm në përkthimin e saj, duke përfshirë kuptimin dhe prodhimin e teksteve të thjeshta..

Rezultatet e pritshme:

- 1.Përvetësimi i gjuhës greke në nivel fillestar (A1) – Studentët do të jenë në gjendje të përdorin struktura gjuhësore të thjeshta dhe të komunikojnë në mënyrë të qartë dhe të saktë në situata të përditshme.
- 2.Aftësi ndërkulturore dhe sociale – Studentët do të kuptojnë rregullat bazë të ndërveprimit gjuhësor dhe jo-gjuhësor në kontekstin grek dhe do të ndërveprojnë në mënyrë të përshtatshme me folësit e greqishtes.
- 3.Përdorimi i saktë i gjuhës në të folur dhe në të shkruar – Studentët do të jenë të aftë të lexojnë, kuptojnë dhe përkthejnë tekste të thjeshta si dhe të përgatisin shprehje dhe fjali të strukturuar në greqisht.